

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “SMILEQUEST” SH.P.K.

Sot, më datën 30.04.2024, **Z.Endri ZEFI** i lindur në Tiranë, Shqipëri me datë 14 janar 1989 mbajtës i kartës së identitetit me numër I90114046F, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Z.Donald SHABANI**, i lindur në Elbasan, Shqipëri me datë 02 Tetor 1989, banues në Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me numër I91002079M, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “SMILEQUEST” Sh.P.K. si më poshtë vijon:

Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin “SMILEQUEST”.

Ortakë të kësaj shoqërie janë **Z.Endri ZEFI, Z.Donald SHABANI**

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z.Endri ZEFI** për një periudhë deri në 5 vjet.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “SMILEQUEST” gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh. P. K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “SMILEQUEST” SH.P.K. është: **Lagjja 4, Rruga Fetah Billaca, Pallati 1133, Kati i tretë, Zona Kadastrale 8514.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Turizem dentar
- Kirurgji dentare
- Estetike
- Konsulencë teknike dhe profesionale në fushën e implantologji, kirurgji estetike dhe fusha të tjera shëndetësore.

Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

Z.Endri ZEFI zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Z.Donald SHABANI zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKET E SHOQERISE

Endri ZEFI

Endri Zefi

Donald SHABANI

Donald Shabani